

Draft Raporti I Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis

Per aktivitetin:

“ Linje ne prodhimin e sapuneve, pluhurit
lares ,detergjenteve likuid ”

Subjekti: Miqesia shpk

Tirane, 2019



Kompania " Miqesia" sh.p.k. ushtron aktivitetin e saj ne prodhimin e sapuneve, pluhurit lares ,detergjenteve likuid. Kjo shoqeri e ka filluar aktivitetin e saj ne maj te vitit 1996. ne komunen Yzberisht ku siperfaqja e truallit ishte me qera Ne vitin 2003 shoqeria " Miqesia" sh.p.k e cvendos aktivitetin e saj ne fshatin Fushe-Mezez, komuna KASHAR ne nje truall me siperfaqe 5000 m2 prone private e shoqerise" Miqesia" sh.p.k

Adresa :Autostrada Tirane-Durres kmi I Mezez Tirane

Objektit ku zhvillohet aktiviteti eshte nje godine me tre kate me aje siperfaqe 1200m2, Kufizohet ne lindje me rruge te asfaltuar qe lidh autostraden me objektet e tjera industriale; ne lindje zhvillon aktivitetin nje firme per prodhimin e parafabrikateve; ne veri ushtron aktivitetin nje zdrukhtari me prodhime druri; ne perendim ndodhet nje servis makinash dhe ne jug ndodhet nje kompleks magazinash

Zona ku zhvillon aktivitetin kjo kompani eshte e miratuar per zhvillimin e aktiviteteve ekonomike Kompania "MIQESIA" SHPK zhvillon aktivitetin e saj ne nje zone me infrastrukture rrugore shume te favorshme (ne anen e djathte te autostrades Tirane -Durres km I Mezez me nje rruge dytesore per levizje ne drejtim te kundert)

Teknologjia eshte gjermane dhe italiane me paisje bashkekohore si per kryeljen e procesit teknologjik ashtu edhe per treguesit e mbrojtjes se mjedisit sipas standarteve te Komunitetit Europian.

Per prodhimet e kompanise MIQESIA SHPK perdoren keto teknologji:

Per prodhimin e sapuneve me baze nudellsat perdoret teknologji gjermane

Per prodhimin e pluhurit lares me baze te parapergatitur perdoret teknologji gjermane

Per prodhimin e detergjenteve liquid perdoret teknologji Gjermane

Funksionimi i tyre jepet ne menyre te detajuar ne perskrimin e procesit teknologjik.

Gjithe njesia prodhim-magazinim, laborator , mjedise pushimi per personelin eshte e vendosur ne nje hapësire te bollshme per nje proces optimal. Vendosija e gjithe paisjeve te nevojshme eshte



zgjdhur ne menyre racionale, funksionale dhe shume praktike, si per realizimin e prodhimit, ashtu dhe per personelin punonjes. duke lejuar nje zhvillim funksional te aktivitetit

Lendet e para dhe ndihmese sigurohen nga importi, kryesisht Maqedonia- soda kaustike, Bullgaria –yndyrnat , Malaysia-pal mitatet e kriprave te sodiumit, Spanja-vajrat aromatike etj. Keto produkte importohen nga kompani serioze te certifikuara me normat dhe standartet e Komunitetit Europian pra jane te nje cilesie shume te mire, gje qe favorizon si realizimin e mire te procesit teknologjik ashtu dhe uljen e kosos se prodhimit.

Objekti furnizohet me energji elektrike sipas kontrates se lidhur me OSHEE

Uji i nevojshem per procesin teknologjik dhe personelin sigurohet ngapus shpimi i shpuar ne teritonirne subjektit ne nje thellesi 45m .Ne funksion te linjave teknologjike jane projektuar dhe kanalizimet

Instalimet elektrike dhe ndricimi jane realizuar sipas standarteve bashkekohore duke lejuar nje funksionim optimal te procesit ne teresi, dhe . mjaft komod dhe per punonjesi

Produkti i gatshem eshte i destinuar per nevojat e tregut te vendit. Shoqeria ka siguruar nje klientele te rregullt ,cka vjen nga cilesia e mire e prodhimit.

Pamvaresisht konkurences, prodhimet e koinpanise MIQESIA shpk kane ardhur gjithnje e ne rritje

Procesi Tehnologjik i Prodhimit te Sapunit te Tualetit

Prodhimi i sapunit te tualetit bazohet ne perdorimin e strushkave te sapunit.Strushkat e sapunit(palmitatet e sodiumit) jane lend.a e pare e cila importohet nga Azia Juglindore.

Keto kripra prodhohen nga bashkeveprimi ivajit te palmes , vajit coco me soden kaustike.

Strushkat e prodhuara nga keto vende perdoren nga te gjitha vendet e Komunitetit Europian. Ky product i nenshtrihet perpunimit mekanik



Amballazhimi i strushkave behet ne thase 25 kg. te cilat hidhen ne transportierin elevator (1,2).Transportieri elevator e con ne peshore elektronike tip DW (5) e cila peshon materiale deri ne 300kg.

Telmologu percakton sasine e perpunimit. Kjo e dhene vendoset ne makinen komanduse te peshores. Me arritjen e peshes se caktuar ne menyre automatike hapet farfalla e peshores(4) duke shkarkuar lenden e pare ne perzjeresin Mixer tip TM 300 B (6).

Me perfundimin e ngarkimit paisja komanduse e peshores jep sinjal per te filluar ngarkimin e elevatorit.

Ne mixer se bashku me strushkat e sapunit futen dhe elemente te tjere:

parfum elemente te ruajtjes se ngyres (oxidues te ndryshem) "lanoline EDTA (etilen diamine tetra acetic)

Ne bordin e kontrollit ndodhet paisja ne te cilen fiksohet koha e perzjerjes (10-20 minuta)

Mbasi materialet jane perzjere dhe uniformizuar me njeri-tjetrin ne menyre automatike me perfundimin e kohes hapet dritarja e shkarkimit dhe materialet bien ne transportier.

Me anen e transportierit materiali I pergatitur cohet ne presen nje shkalleshe tip E 250 (7).Kjo makineri realizon ngjeshjen dhe uniformizon materialin.Presioni i ngjeshjes arrin ne disa atm.

Materiali qe eshte ne kontakt me sapunin eshte inox. Fuqia motorike e instaluar eshte rreth 20kw. Materiali i pergatitur grihet nga makina grirese dhe bie ne transportierin (8).

Transportieri e con ne makinen laminator e cila perbehet nga 4 cilindra siperfaqja e te cilave ka nje prites 60 HRC(9).

Sapuni ne kete rast ngjeshet dhe merret nje shtrese prej 20 mikron.

Rezultati: ne sapun dhe ne siperfaqen e tij nuk ka mbetur asnje kokrize e pa homogjenizuar.

Cilindrat jane inoksidabel dhe fuqia e instaluar ne kete makineri eshte 25 kw.



Materiali I dale nga laminatori (9) ne anen e transportierit (10) shkon ne presen dyshkalleshe tip DVE 300Kr (I I). Ne stadin e pare kjo prese realizon ngjeshje dhe uniformizim te te gjithë elementeve qe ndodhen ne sapun. Strushkat e sapunit dalin nga staid i pare dhe bien ne dhomen e vakumit. Ne kete dhome realizohet perpunimi duke larguar fluskat e ajrit qe mund te permbaje sapuni. Ne fund te ketij procesi shkalla e homogjenizimit dhe perpunimit te sapunit eshte maximale.

Sapuni del nga pjesa konike e preses dyshkalleshe me form qe eshte percaktuar Fuqia e instaluar ne kete makineri eshte 50 kw.

Nga kjo makineri sapuni kalon ne preresen e kallepeve RicoHV (12) Prerja e kallepeve behet ne gjatesine qe kerkohet (nga 40 mm- 300 mm)

Shpejtesia e prerjes eshte e pandryshyeshme. Kallepet e sapunit nga prerësja kalojne ne transportierin (13) me anen e nje shperdaresi te sapunit(13.3) kalojne ne makinën stampuse (I 3.2) me kapacitet stampus 200 cope per minute dhe me dy linja ushqimi.

➤ **NDIKIMET NEGATIVE NE MJEDIS**

○ **Ndikimet ne klime**

Gjate zhvillimit te aktivitetit nuk priten ndryshime te dukshme klimaterike, si ne drejtim te permiresimit ashtu edhe ne ate te perkeqesimit te saj. Nuk do kete ndryshime ne temperature, ne drejtim te eres, ne sasine e reshjeve. Pra kryerja e ketij aktiviteti nuk ndikon fare ne kushtet klimaterike te kesaj zone.

○ **Ndikimet nga zhurmat dhe vibracionet**

Nuk do te ketë ndikime nga zhurmat dhe vibracionet pasi pajisjet dhe mjetet jane ne pjesen e brendshme te subjektit dhe nuk kane emetime ne mjedis.

○ **Ndikime nga shkarkimi i ujerave**

Uji qe perdoret ne procese eshte me cikël te mbyllur, dhe nuk ka shkarkime ujerash teknologjike ne ujera siperfaqesore apo kanalizime. Te vetmet ujera qe derdhen ne kanalizime jane ujerat higjieno – sanitare.



